



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

AD/GJTHPR/04/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga B.B për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.A.K, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 27.03.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga B.B ndaj gjyqtares L.A.K për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 12.03.2024 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka pranuar ankesën e ushtruar nga B.B për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.A.K.

Parashtruesja e ankesës në ankesën e saj ka deklaruar se me datë 13.12.2022 ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative kundër vendimit të Komisionit Komunal për shqyrtimin e Ankesave për Zyrtarët e Shërbimit Publik të datës 08.12.2022, DKA, Fushë Kosovës. Sipas saj, gjyqtarja L.A.K fillimisht ka kërkuar informata shtesë rreth padisë, me arsyetimin se nuk ka të dhëna të qarta rreth padisë, e më pastaj me datë 19.05.2023 nxjerrë aktvendim se kjo padi do të përcillet në Departamentin e Përgjithshëm – Divizionin Civil. Sipas saj, është hera e tretë që nga muaji Maj 2023, tetor 2023 dhe tani me datë 23.02.2024 që gjyqtarja L.A.K e dërgon aktvendimin e padisë përmes postës tek e njëjta, ku deklaroi se në tre rastet e kemi pranuar aktvendimin dhe është nënshkruar te zyrtari i cili e ka sjellë postën në adresën tonë. Tutje ka deklaruar se është e bindur se kjo gjyqtare është duke vepruar me qëllim që lënda të zvarritet sa më shumë dhe të kalon afati i vendim marrjes, andaj ka kërkuar që të hetohet sjellja e saj, të merren masa nga se me veprimin e saj po dëmton të drejtën e parashtrueses së ankesës dhe gjithsesi imazhin e Gjykatës dhe drejtësisë në Kosovë.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara, Autoriteti Kompetent nuk ka arritur që të marrë një deklaratë nga gjyqtarja e çështjes pasi që e njëjta gjendjen në pushim të lehonisë, mirëpo ka tërhequr lëndën në mënyrë që të shqyrtoj pretendimet e paraqitura.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës L.A.K.

Nga shkresat e lëndës nuk është kontestuese se gjyqtarja e çështjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi, ku me datë 02.05.2023 ka nxjerrë vendimin përmes së cilit paditëses i ka kthyer në plotësim padinë, me qëllim të precizimit.

Me datë 19.05.2024, respektivisht 7 ditë pas pranimit të precizimit, gjyqtarja e çështjes nxjerr aktvendimin A.nr.2870/22 përmes së cilit e shpall Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë jo kompetent, ku në dispozitivin e dytë të këtij aktvendimi përcaktohet se lënda i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Civil, pasi që aktvendimi të marrë formën e prerë.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, aktvendimet të cilat gjykata i jep jashtë seancave gjyqësore u komunikohen palëve duke iu dërguar kopja e vërtetuar e aktvendimit, ku sipas këshillës juridike palët kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Pas kalimit të kësaj date dhe nëse palët nuk paraqesin ankesë, vendimi i tillë bëhet i plotfuqishëm.

Në rastin konkret, në bazë të shkresave të lëndës, vendimi A.nr.2870/22 i datës 19.05.2024 është dërguar në mënyrë të rregullt dhe në shkresat e lëndës është vetëm një dëshmi e pranimit, e cila mban datën 27.02.2024 si datë të pranimit të vendimit nga ana juaj. Kjo ka bërë që gjyqtarja e çështjes të llogarisë afatin e plotfuqishmërisë së vendimit për jo kompetencë nga kjo datë.

Problemet në lidhje me dërgesat e shkresave nuk mund t'i faturohen gjyqtarës së çështjes, pasi që e njëjta nuk mund të dërgoj lëndën në asnjë departament tjetër kompetent pa kalimin e afatit të plotfuqishmërisë, me çka në bazë të shkresave të lëndës konsiderohet se e njëjta ka vepruar në bazë të autorizimeve të saj, duke mos dërguar lëndën në asnjë departament tjetër deri në pranimin e fletë kthesës si dëshmi të pranimit nga ana juaj.

Në bazë të informatave të pranuar, lënda tashmë ka kaluar afatin e plotfuqishmërisë dhe si e tillë ka kaluar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ka marrë numrin C.nr. 3612/24.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/04/24, me datë 27.03.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë